



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Nr:3	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Data e mbajtjes:	11.10.2022 Ora: 16:00
Vendi i takimit:	Salla e Kuvendit Komunal
Mbledhjen e kryesoi:	Nënkryetari i Komunës: z. Ali Nimanaj <i>Ali Nimanaj</i>
Procesmbajtës:	Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave <i>Skender Hasangjekaj</i>
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none">1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;3. Tahir ef. Bekaj, Bashkësia Islame;4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,5. Jerej Nebojsa Sekulliq, Kisha Ortodokse,6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar;7. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;8. Sead Hotović, Komuniteti Boshnjak;9. Ganimer Shaqiri, Komuniteti Romë;10. Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas;11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;14. Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;15. N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;16. Enver Boletini, KLSP-Gurakoc;17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;18. Blendinela Shatri, EVSB;19. Skendr Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;20. Enisa Ćorović, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;21. Blendor Isufaj, KVRL;22. Zeqir Mehmetaj, Radio“Fontana“;23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS;24. Armir Arifaj ShKK Burgu i Dubraves, dhe25. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.

	<p>Mungojnë: Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike; Jerej Nebojsa Sekulliq, Kisha Ortodokse Sead Hotović, Komuniteti Boshnjak, N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK Enver Boletini, KLSP-Gurakoc; Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;</p> <p>Pjesëmarrës tjerë: Abedin Kabashi, Drejtor i Drejtoratit Sherbime Publike, Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i PUM, Astrit Hajrizaj, Drejtor i BPH, Genc Ademaj, Komuna Istog, Lirije Demiri, Komuna Istog, Ardon Arifaj, Komuna Istog; Mehmed Qeman, përkthyes;</p>
	<p>Blerim Gerguri, përkthyes, Ali Blakaj, KRU" Drini i Bardh" Atdhe Fetahu, RTV Fontana,</p>
<p style="text-align: center;">Rendi i ditës:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i Rendit të ditës, 2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit, 3. E drejta për punë: <ul style="list-style-type: none"> -Puna në sektorin privat -Orari i punës -Kontratat e punës 4. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK -së 5. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqshues të komuniteteve etj.) 6. Ndotja e ambientit-lumenjve dhe deponit ilegale 7. Prerja ilegale e pyjeve, konfiskimi dhe deponimi (deponija) i masës drunore 8. Vërshimet në stinët e të reshurave 9. Të ndryshme 	

1. Miratimi i rendit të ditës.

Ali Nimanaj, Nënkrjetar i Komunës - Përsëndet të gjithë të pranishmit, anëtarët e KKSb-së. Njëheri Përsëndet edhe antarin e ri të KKSb-së nga ShKK " Burgu i Dubraves" z. Armir Arifaj. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve dhe shtoj se Nga Inspektorati i punës na kan dergu një njoftim lidhur me inspektimet dhe që nuk kan mundsi të jen prezent për paraqitje të raportit dhe debatit andaj propozoj që pika tre e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhes. Në vazhdim pyeti a ka propozime për ndryshim të rendit të ditës.

Pasi që diskutime nuk pat:

Rendi i ditës u miratua me propozimin për ta shtyr piken dy te rendit të ditës..

2. Miratimi i procesverbalit nga Mbledhja e kaluar

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës –Pyeti antaret e KKSB-së a ka dikush vërejtje në procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Me qe nuk pati vërejtje, Nënkyetari pyeti kush është për miratimin e procesverbalit. Gjithë antarët e KKSB-së votuan për miratimin e procesverbalit.

3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - vazhdojmë me piken e rendit të ditës, fjalën ja kalon komandantit të Policis.

Tog. Qazim Jahaj zv. Komandant i St. Policis Istog –Gjëndja në zonën e përgjegjësis së stacionit Istog është e qetë, stabile dhe e qendrueshme. Në vazhdim paraqes raportin nënt mujor me krahasimin e periudhes së njëjt për vitin 2021.

Raste të inicuar për këtë nënt mujor i kemi 555; në vitin 2021, 476; 16% rritje
Vepra penale të inicuar kemi 410, ndersa në vitin 2021 339, kemi rritje të rasteve për 20.9%. zbulueshmerin e rasteve penale në vitin 2021 e kemi 67.4% ndersa në vitin 2022 e kemi 76.1%.

Aksidente në trafik ne vitin 2021 kemi pas 116, ndersa në vitin 2022 129, pra kemi rritje 11.2%. Nga këto, aksidente me lendime i kemi 29 në vitin 2021 dhe 29 në vitin 2022, aksidente me dëme materiale 77 në vitin 2021, ndersa 100 në vitin 2022, pra kemi rritje për 14.9%. Persona të lënduar kemi 54 në vitin 2021, në vitin 2022 kemi 48 pra kemi rënje për 11.1%.

Tiketa të shqiptuara në vitin 2021 kemi 1846, ndersa në vitin 2022 kemi 4606, kemi rritje për 149.5%.

Persona të arrestuar kemi 268 në vitin 2021, ndersa në vitin 2022 318, prej të arrestuarve përsona të ndaluar kemi 65 në vitin 2021, ndërsa 117 në vitin 2022.

Armë të konfiskuara kemi 39 në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 kemi 41, municion të konfiskuar kemi 438 në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 kemi 213.

Asistime të ndryshme në vitin 2021 kemi pas 71, ndersa në vitin 2022 kemi 61. Nga rastet ma sensitive, në vitin 2021, lëndime trupore kemi pas 3 raste ndërsa në vitin 2022 kemi 2 raste. Lëndim i leht trupor kemi pas 47 në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 kemi 55 kemi rritje prej 17%.

Viedhje në vitin 2021 kemi pas 43, ndërsa në vitin 2022 kemi 40 pra kemi ramje prej 7%. Vjedhje të rënda në vitin 2021 kemi pas 25 ndërsa në vitin 2022 kemi 33. Grabitje në vitin 2021 kemi pas 2 ndersa në vitin 2022 kemi një rast.

Dhunë në familje në vitin 2021 kemi pas 58 raste ndërsa në vitin 2022 kemi 34 raste, pra kemi ramje prej 31.4%. Situata e përgjithëshme paraqitet e qet dhe stabile në komunën tonë.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - E falenderoj togerin dhe pyeti a ka dikush nga antaret pyetje.

Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë - kamë pyetje për togerin lidhur me sigurin në Shkolla, a ka pas ndonjë rast të veçant, aksidente apo gjëra tjera.

Tog. Qazim Jahaj zv. Komandant i St. Policis Istog - sa ju perket Shkollave, ne kemi një Plan Operativ me të cilin prezenca e Policis është në afersi të objekteve permanent, jemi në kontakte të vazhdueshëm me Drejtorët e Shkollave. Jemi duke i trajtuar gjitha rastet që kan ndodh, për momentin nuk kemi ndonjë rast senzitiv.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar- do të ishte interesant, nese do të ipeshin edhe sukseset në raste të veçanta të Policisë gjatë ndjekjes dhe zbulimit të krimeve dhe a ka ndonjë rast që nuk kan mujt me i zgjedh. Numrimi taksativ që e paraqiti togeri edhe mund të jet në rregull por neve na interesojn problemet konkrete apo raste të veçanta që mund tu ket ikur Policisë që nuk ka mujt me zgjedh. Sepse rastet dallojn kemi raste nese mund ti quaj rutinore dhe raste më të randa.

Tog. Qazim Jahaj zv. Komandant i St. Policis Istog - Disa raste trajtohen nga Stacioni i Istogut, ndersa disa raste trajtohen nga Drejtoria rajonale në Pejë. Pra për rastet më të rana merren njësit e specializuara nga Drejtoria Rajonale në bashkëpunim me stacionin tonë.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar- E kuptoj se në raste të veçanta ka edhe diskrecion ng Policia, por nëse ka raste që nuk janë të tilla, a ka mundsi tna informoni.

Tog. Qazim Jahaj zv. Komandant i St. Policis Istog - nese ka raste të veçanta që parashtroni pyetje mundim edhe tju pergjigjemi dri kund ka rrjedh rasti i cili nuk ka diskredicion ndersa për rate të tilla pala e interesuar e (përfshir në rast) mund të lajmrohet në stacion dhe i merr informatat).

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave- I perciella statistikat e paraqitura në veçanti ato në aksidente në trafik ku kemi rritje të aksidenteve prej 11.2% dhe me dëme materiale prej 14.9%, ndersa raportet nga Policia e Kosovës në veb Faqen ku perfshihet Rrafshi i Dukagjinit në tërsi ku vrehen ramje në këto dy të dhëna. Pyetja është a ka bër ndonjë analiz stacioni i Istogut pse në komunën tonë ka rritje kur në të gjitha komunat si regjion ka ramje të këtyre dy statistikave. Këtë problem e shtraj sepse bazuar në UA do të duhej që KKSB të nxjerr rekomandime për zgjidhjen e problemeve, mos të mbetet që Policia paraqet statistikat, antarët i ndegjojn dhe nuk ka ndonjë bashkëpunim ma të avancuar qoft në këtë problem në komunikacion apo edhe sfera tjera. Thën ma thjesht a ka Policia ndonjë kerkes nga antarët e KKSB-së për ndihmë-bashkëpunim për aq sa UA ju jep kompetenca, apo na mbetet neve që të bëjm kërkes Policis ti ndermerr masat që kjo statistik të permirsohet në komunën tonë në krahasim me Komunat e Rrafshit të Dukagjinit dhe Kosovës në tersi.

Tog. Qazim Jahaj zv. Komandant i St. Policis Istog - E verrtet është se Drejtoria rajonale i paraqet statistikat bazuar në të dhënat e komunave veç e veç dhe kjo tani ndryshon si statistik në tersi. Statistikat tona janë reale, janë edhe disa faktor që kanë ndiku. Ma heret ju kemi drejtu komunës me kërkesë për shenja në komunikacion. Zgjidhja e këtij problemi, vetdijesimi i qytetarve, Planet e Policisë, angazhimi i Policis i cili mund të shihet edhe përmes rritjes së tiketave, por që nuk e kanë arritur efektin e duhur në këtë moment do të duhej të ndikojn në zvoglimin e rasteve.

Zeqir Mehmetaj, Radio“Fontana“- Toger kerkoj falje në fillim, këpucët që i ke mbathur a i ke të Policis së Kosovës apo investim veanak.

Tog. Qazim Jahaj zv. Komandant i St. Policis Istog - Janë të Policis së Kosovës.

Zeqir Mehmetaj, Radio“Fontana“- të jemi korrekt, ne kemi ankesa, posedojm edhe foto material me këpuc të shkyera, uniform të shkyer, me automjete që teknikisht as alarm nuk kanë për ndjekjen e veturave që kanë shkakto veprën, me goma zero. Këto fakte më bëjnë të mendoj se ju jeni shumë pozitiv në kryerjen e detyrave ditore në krahasim me mbeshtetjen logjistike që e keni.

Tog. Qazim Jahaj zv. Komandant i St. Policis Istog - sa i perket stacionit të Istogut mund të them që e dhëna që ju e paraqitët nuk qëndron, për stacione tjera nuk jamë në dijeni. Tjeter koment nuk kamë.

Zeqir Mehmetaj, Radio “Fontana“- Pikrisht për Istog fola dhe ju thash se i kamë edhe faktet. Nuk është marre të thuhet nuk i kemi për “x” arsye. Pse juve ju mungojn gjerat elementare nuk është faji juaj, është faji ma nëlt.

Blendor Isufaj, KVRL - ka shumë shqetsime për perdoruesit e trotinetve elektrik që kanë shkakto edhe aksidente me lendime dhe tentativa për ndalimin e tyre për perdorim në veçanti për të miturit. A keni informacione a ka pasur aksidente në komunën tonë dhe a ka ndonjë analiz apo vlersim për ndalimin për perdorim për të mitur.

Tog. Qazim Jahaj zv. Komandant i St. Policis Istog - Në komunën ton deri me tani nuk kemi pasur raste të aksidenteve në trafik, por shpresojm se perdorimi i tyre do të rregullohet me Ligjë.

Genc Ademaj, Drejtor për Ekonomi dhe Zhvillim- Kryetari i Komunës i organizon degjimet publike me qytetar nga të cilat kanë rrjedh shumë kërkesa që duhet perfshi në Planin Zhvillimor. Një kërkes që është ngritur sa i perket siguris është edhe çeshtja e nënstacionit në Banjë dhe në Gurakoc. Një kerkes të till ngritur nga qytetarët, ne e kemi adresuar me shkrim tek Komandanti i stacionit por ende nuk kemi marr pergjigje. Pyetja është a planifikon stacioni rihapjen e tyre, apo keni ndonjë arsye pse nuk do rihapen.

Tog. Qazim Jahaj zv. Komandant i St. Policis Istog - sa i perket kësaj çështje ne kerkesën e Komunës e kemi adresu në Departamentin përkatës dhe presim pergjigjen.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Kerkes per komandantin e Policis për mbledhjen e ardhëshme të pergatis një prezantim deri kun ka shkuar vlersimi dhe analiza e hapjes së nënstacioneve, a ka ngecje, cila është arsyeja e ngecjes apo ka avansim dhe deri në çfar niveli.

4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqshues të komuniteteve etj.)

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Me që perfaqshuesit ë Kforit nuk janë të pranishëm pyet perfaqshuesit e institucioneve tjera a kanë ndonjë çështje për ta diskutuar.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim - Jeni në dijeni që procesi edukativo arsimor ka fillu me një muej vones. Të gjitha shkollat i kanë kryer procedurat pergatitore me kohë. Informat që mund të jet e rëndsishe për këshillin e prinerve dhe ju është se DKA-ja ka pezulluar perkohsisht ekskurzionin e maturantve në Shqipëri. Kerkesa ka buru nga një numer i prinderve, bazuar në gjendjen ekonomike, në humbjen e një muaji të procesit mësimor dhe si vendim i till është mirëpritur nga prinderit por nuk e besoj që është mirprit edhe nga vetë maurantët. Sa i perket siguris në shkolla jemi në bashkëpunim të vazhdueshëm me policin e Kosovës të cilët janë gjithnjë pranë shkollave në bashkëpunim me Drejtorët e shkollës perkatse. E falenderoj Policin në bashkëpunim.

Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas - Drejtor a do të kompenzohen oret e humbura gjatë këtij muaji.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim - Në kalendarin që ka ardh nga Ministria thuhet se po. Zotimi i Kryetarit është per po dhe ne si DKA jemi për po, Ligji për greva thotë ndryshe, na mbetet në vazhdim ta zgjedhimkëtë çështje.

Blendor Isufaj, KVRL - sa i perket paraleles së ndar nga ShFMU 'Marrtin Camaj' në Serbobran ku kohë më parë ka humbur jeten një fmi pës vjeçar, a janë ndermarr masa të siguris në komunikacion në afersi të kësaj shkolle.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim - në bashkëpunim me DSHP-e kemi vendos shënja të komunikacionit për kufizimin e shpejtësis në 40 në orë. Në bashkëpunim me Policin e Kosovës është vendos që kohëpaskohe të jenë Policia prezente në afersi të shkollës për vezhginin e gjendjes dhe të shpejtësisë. Me që është rrug regjionale, ne nuk kemi të drejtë të vendosim pengesa në rrugë.

Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana"- E njoh sferen e Arsimit me që kanë punuar gjatë në Arsim dhe jamë pjesë e Këshillit të Prindërv në Gurrakoc edhe pse nuk më ka ftuar kush në takim, e përkrahi plotësisht vendimin për pezullimin e ekskurzionit. Gati 20% e kalendarit vjetor të mësimit është humb me grevën, nisur nga ky fakt , jamë për ata të ndalohet ekskurzioni, por duhet menduar dhe kaluar edhe në anën e fëmijve mos tu mohohet e drejta e tyre, pra nisur nga ky fakt propozoj të bëhet vlersimi dhe në fund të procesit mësimor tju lejohet shkuarja në ekskurzion.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim - Edhe UA e precizon që ekskurzioni për maturant mund të organizohet në fillim të vitit shkollor gjatë muajit të parë apo të dytë ose në fund të vitit shkollor. Nisur nga ky fakt jemi dalur me komunikat për pezullim jo ndalim i ekskurzionit. Pra në muajin Prill apo Majë këshilli i nxënësve me Drejtorët e shkollave do ta bëjnë vlersimin dhe propozimin konkret.

Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë - Pyetje për Drejtorin, a ka fillu të ndermirret diçka lidhur me rekomandimet e dala nga komisioni i KKSB-së, lidhur me parkingjet brenda shkollave me që paraqet rrezik transporti i fëmijve me mjete vetanake të prindërve. Nese nuk lejohen të hyjnë në oborret e shkollave. A keni bër vlersim me DSHP-e me u bë rregullimi dhe shënjzimi i parkingjeve brenda oborrit të shkollës edhe pse në shumicën e shkollave me Vendim të Këshillit Drejtues është ndaluar hyrja në oborr.

Vendimi për uniforma a ka fillu zbatimin apo deri kund është procesi për shkollat prej 1-9 dhe e treta çeshtja e transportit të nxënësve bazuar në deklaratën që nga shkolla profesionale në Gurrakoc 100 nxënës na ikin në Shkolen profesionale në Pejë.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim - Faleminderit Robert, je kryetar i këshillit të prindërve dhe nga kjo ty të takon më së shumti me fol për arsim. Po ka Shkolla ku prindrit hyjnë në oborrin e shkollës, një e tillë është " Martin Camaj" në Gurrakoc, e kemi bisedu me Drejtoreshën që të hapet pjesa e rruges kah çerdhja në mënyr që prindërit ti lënë fëmijet në oborr dhe të vazhdojnë daljen kah çerdhja për mos të rrezikuar fëmijet. Ndërsa në Vrellë, Banjë dhe Rakosh nuk kanë nevojë të hyjnë në oborrin e shkollës por i lajnë afer dhe nuk rrezikohen fëmijet.

Sa i përket uniformave mund tju jap një lajm të gzuashem Prindërve që për her të parë me pages nga Komuna fëmijet do të paisejnë me uniform, tenderi është hapur dhe për her të parë në nivel Kosovës uniforma sigurohet nga Komuna.

Sa i përket transportit, Drejtorët i kanë siell listat dhe çdo nxënës që udhëton mbi 4 km do të sigurohet transporti ndërsa sa i përket ikjes që problem është për Kaliqanin, shkollimi i mesëm nuk është obligativ andaj kemi vështirësi dhe ky fakt paraqet sfidë për ne por në vazhdimsi do të bëjmë përpjekje për rregullimin e vijës Shkollë fshat dhe jemi duke bër vlersimin buxhetor për vitin e ardhshëm. Pra theksoj edhe një herë me Ligjin për arsimin nuk jemi të obliguar por duhet të bëjmë gjithçka është në mundësit tona që fëmijet mos tna shkojnë në komunat tjera për drejtimet që i kemi në Komunën tonë.

Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë - Falenderoj Drejtorin për pergjigjet, kërkoj nga Nënkyetari që me stafin e Administrates komunale ta marrin shumë seriozisht këtë tem sepse tna largohen 100 nxënës sipas të dhënave nga shkolla profesionale "Mitëhat Frashëri" është shqetsuese dhe duhet gjetur një zgjidhje për organizimin e transportit. Edhe pse shkollimi në këtë nivel nuk është obligativ janë dy apo tri shkolla në komunën tonë që ju paraqiten këto probleme të largsis nga vendbanimet. Shpresoj që nënkryetari ta merr këtë tem me seriozitet dhe urgjencë.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Para se të pergjigjem në kerkesën tuaj dua të kerkoj nga secili anëtar i KKSb-së që në takimet e radhes të vijm me propozime konkrete, me rekomandime konkrete mënyr që ti perciellim rekomandimet dhe konkluzionet dhe nga kjo do të jemi edhe më ekspeditiv në rrjedhojen e takimeve. Javen e kaluar kemi qën në vizita në Shkolla bashk me Kryetarin, Drejtorin dhe stafin tjetër dhe i kemi pranuar këto shqetsime edhe nga shkolla në veçanti për nxënsit nga Kalijani dhe Suhogerlla dhe jemi duke e analizuar pjesen buxhetore dhe vijat e transportit sepse nxënsit duhet ti ndrojn dy autobusa për transport deri në Gurrakoc. Besoj se së shpejti do ta gjejm një zgjidhje sepse është jetike për nxënsit dhe është pergjegjsi e jona si qeverisje komunale që tju krijojm kushte gjithë të rijve që ta realizojn ëndrrën e tyre për të ndjekur mësimin në Shkollën e dëshiruar.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim - Robert sa i perket numrit prej 100 nxënësve, nuk është numer i sakt, sepse informaten që unë e kamë nga Shkollat është numri prej 35 nxënësve që kanë vijuar mësimin në Pejë, nga të cilët disa janë në Shkollën e Mjekësis disa në Shkollën Ekonomike e cila i ka edhe degët profesionale, mirëpo edhe ky numer prej 35-ve është një norm e gjysëm e një msimdhënsit tonë dhe duhet luftuar që ata ti ndalim në komunën tonë.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Pershendetje të veçant edhe një her për Përfaqsesin e Sherbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) dhe e pyes a ka ndonjë çeshtje për ta ndar me antarët e KKSb-së edhe pse është takimi i par .

Armir Arifaj ShKK Burgu i Dubraves - Ju faleminderit Nënkyetar, jo nuk kamë diçka të veçant për këtë takim dhe ju deshiroj punë të mbar.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Falenderon Amirin, pyet a ka ndonjë çeshtje tjetër lidhur me këtë pikë.
Nese jo atëher kalojmë në pikën e radhes të rëndit të ditës.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim - DKA-ja ka ndermarr masa që të organizoj transportin për të gjith nxënsit që udhtojn mbi kater (4 km), pa dallim races, gjinis etj. Për të gjitha kerkesat e parashtruara mbi largësin e cekur kemi hapur tender, ndersa për vendbanimet që ju i cekët janë nën dy kilometra nga Shkolla dhe nuk kemi baz Ligjore që të organizojm transport. Kjo është pergjigja e DKA-së.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderoj Drejtorin e DKA-së dhe pyet antarët e KKSB-së a ka diskutime tjera lidhur me këtë pikë. Me që nuk ka diskutime kalojm në pikën e radhes të rendit të ditës.

5. Ndotja e ambientit-lumenjve dhe deponit ilegale

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - lidhur me këtë tem pjesën e parë do ta paraqes Drejtori i Urbanizmit Dukagjin Hoxha, ndersa pjesen tjetër Drejtori i SHp-së Abedin Kabashi. Fjala për Ju Drejtor.

Dukagjin Hoxha, Drejtor i Urbanizmit dhe Ambientit - I nderuar nënkryetar, antar të KKSB-sëmë lejoni që në pika të shkërtra ta bëj një elaborim të gjendjes. Në pjesen më të madhe të komunës tonë nuk egzistojn impiantet për trajtimin e ujrave të zeza, por edhe atje ku egzistojn nuk funksionojn, sikurse është rasti me impiantin në fsh, Baicë i cili ka qën i planifikuar për trajtimin e ujrave të zeza nga disa fshatra por që është tërsisht jashtë funksioni. Ndotsit kryesor siperfaqësor janë vendbanimet ku ujrat e zeza shkarkohen pa trajtim dhe pa kontroll në lumenj duke shkaktuar kështu ndotjen e lumenjve me materiale organike dhe mikrobiologjike. Faktor tjetër i ndotjes janë edhe hedhja e mbeturinave në brigjet e lumenjve me çrast krijohen edhe deponi ilegale dhe jo vetem por edhe në vende tjera dhe nga rrjedhjet e lëngjeve ndoten lumenjt dhe ujrat nëntoksore. Faktor tjetër është edhe perdorimi i kemikateve jo profesionalisht që kryesisht perdorën në Bujqësi dhe në mënyr direkte ndikojn në ndotjen e mjedisit. Në bazë të të dhënave sipas PZH të Istogut, ndotja është me sa vijon: Pjesa rrjedhore e lumenjve nga Istogu dhe Vrella gjer në piken ku bashkohen konsiderohet në shkallën e parë.

Rrjedha e lumit Istog gjer në derdhjen në lumin Drin konsiderohet në shkallën e dytë.

Këto janë të dhënat nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Abedin Kabashi, Drejtor i Sherbimeve Publike- Pershendet të prënishmit, Drejtoria ka bër evidentimin e deponive ilegale dhe ka konstatuar se janë 18 deponi ilegale, kemi ndermarr masa dhe kemi shpall tenderin para 5 javesh është perzgjedh operatori ekonomik dhe pritët që brenda javes së ardhshme të filloj punën në eliminimin e deponive ilegale. Kaq për fillim, jam i hapur për pyetje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Falenderoj Drejtorët dhe hap debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Me që nuk ka pyetje konsideroj të shtjerrur këtë pikë dhe kalojm në pikën e radhes të rendit të ditës.

6. Prerja ilegale e pyjeve, konfiskimi dhe deponimi (deponija) i masës drunore

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - lidhur me këtë pik të rendit të ditës ftoj Drejtorin e Bujqësis z. Astrit Hajrizaj ta parqes një raport.

Astrit Hajrizaj, Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi, pylltari- Pershendet të

pranishmit, sa i perket prerjeve ilegale të pyjeve, për këtë periudh kemi 49 fletëparaqitje nga të cilat 40 janë për kundervajtje ndersa 9-të nga to janë fletëparaqitje Penale. Nga këto fletëparaqitje kemi të bëjm me masen drunore prej 188.35 meter kub të konfiskuara dhe të deponuara në oborrin e objektit të Pylltaris në Sinë. Gjatë periudhes së kaluar sektori i Pylltaris është ballafaquar me sfida të ndryshme nga të cilat vlen të theksohet mungesa e stafit, por me një angazhim maksimal të pylltarve dhe të stafit në laur kemi menaxhuar mirë situatën. Tani jemi në fazën perfundimtare për pranimin e stafit në sektorin e Pylltarisë e që do të ndikoj në mbarvajtjen e punëve, pas prënimit të detyrave nga ky staf. Ky ishte një raport në pika të shkurta, jam i hapur për pyetje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Hap debatin lidhur me këtë pik të rendit të ditës.

~~**Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë -** A ka projekte senzibilizuese për mënyren dhe kushtet e prerjes së pyllit në pronsi private.~~

Astrit Hajrizaj, Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi, pylltari- Po ka procedura dhe egziston koha për parashtrimin e kërkesave në Drejtorin tonë dhe ne i procesojm kërkesat në zyren rajonale të Pylltarisë në Pejë. Inxhinjerët e tyre e vlersojn dhe e përcaktojn masën drunore të lejuar për prerje të cilët e bëjn Vendimin dhe damkimin e masës drunore dhe njoftohet pala, më pastaj bazuar në këtë Vendim Pylltari e pais me dokumentacion gjegjësisht fletëperciellje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Me që nuk ka pyetje apo komente tjera lidhur me këtë pikë kalojm në pikën e radhes të rendit të ditës.

7. Vërshimet në stinët e të reshurave

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Ftoj përfaqsesin e kompanis "Drini i Bardhë" z. Ali Blakaj, që tna elaboroj këtë piokë të rendit të Ditës.

Ali Blakaj, perfaqses i ndermarrjes Drini i Bardhë" - Njësia punuese në Gurrakoc vepron në kuader të ndermarrjes rajonale "Drini i Bardhë " Pejë. Veprimtaria kryesore e kësaj ndërmrrje është ujitja e tokave bujqësore që fillon nga Maji deri me 15. Shtator. Këtë vit pergatitjet janë bër me sukses, është bër pastrimi i kanaleve dhe kemi filluar me punë me kohë. Edhe pse pranvera ka qën e thatë dhe nevoja për ujitje ka qën e shtuar, nuk kemi pas probleme me bujq gjatë ndarjes së ujit dhe kohes për ujitje gjegjësisht vaditje. Ndersa pjesa e dyt e veres ka sijell të reshura ma të mëdha dhe nevojat për vaditje janë reduktuar. Me 15 shtator bëhet servisimi i pëndave gjegjësishtë ngritja e pëndave, ndermarrja jonë i menaxhon 8-të pënda.

Pra ne e kemi kryer servisimin dhe ngritjen e pëndave dhe nuk ka rreziqe për vershime si pasoj e mosngritjes së pëndave, por problem kryesor është lumi i Istogut i cili është mbushur me zallë dhe është në projekt pastrimi i shtratit të lumit.

Me kryerjen e këtij projekti nga ana e Komunës krijohen kushte për kullimin dhe mos daljen e ujrave nëpër kanale dhe nuk do të ket as vershime në kushte normale të të reshurave atmosferike. Me perfundimin e sezonit ne i kemi pastruar kanalet, i kemi ngrit pendat dhe ndermarrja jonë nuk do jetë shkaktare e vërrshimeve.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - e falenderon z. Ali Blakaj për raportin e paraqitur dhe hap debatin lidhur me këtë pikë të rëndit të ditës.

Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb- Përshendet të pranishmit, kamë një pyetje për drejtorinë dhe përfaqësuesin e Drinit të Bardhë, kamë mbi 400 metra të kanalit të ujitjes gjer në jazin e Tomocit. Përfaqësuesi i Drinit të Bardhë ka qen i njoftuar me problemin tim dhe para dy viteve e ka bër pastrimin e këtij jazi dikun rreth 50 metrave i cili është i mbushur me shishe plastike dhe mbeturina tjera por që është terhekur dhe nuk është bër pastrimi i jazit gjer në prronin e "Shushica". Këtë vit kam kerkuar serish intervenimin permes Drejtorit në Pejë të cilin e falenderoj, me që menjëëher i ka derguar punëtoret dhe e kanë sanuar gjendjen dhe gruri i cili ka qen i mbuluar me ujë është kulluar, Nuk e kamë pas vetëm unë këtë problem por i gjithë Dragolevci i ultë është ballafaquar me vershime. Pra problemi është se kanalet që kanë qen të hapura deri në prrojin Shushica janë të mbyllutra dhe si pasoj krijohen vërrshime sepse ujrata nuk kanë kah të shkojn.

Ali Blakaj, përfaqësues i ndermarrjes Drini i Bardhë" - jamë në dijeni me këtë problem dhe para dy viteve kemi intervenuar por është tejet e veshtir të mirëmbahet, me qe ka hedhje të mbeturinave qoft nga ndermarrje qoft nga qytetar dhe jazi po mbushet me mbeturina të llojllojshme andaj intervenimet do të duhet të jenë shumë ma të shpeshta edhe në pastrim por edhe në parandalim.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar- problemi i ujitjes është problem i madh, në Istog kemi pas ujë të mjaftueshëm për ujitje, por së fndi po ndodh një paradoks i madh, konkretisht e kam fjalen për kanalën i cili shkon në drejtim të Dubraves i cili është i dedikuar për ujitje. Mbas lufte është rregulluar me donacion për ujitje të tokave. Së fundmi në këtë drejtim janë themeluar ndermarrje të peshkataris gjegjësisht hurdhja të peshkut, dhe e shfrytëzojn këta ujë dhe tash nuk ka shans që të ujitin tokat perfundi lagjes së Bujupve. Nuk jam i sigurt a është kompetenc të pergjigjet z. Ali apo dikush tjetër, a është në dijeni "Drini i Bardhë për këtë problem sepse ka ankesa të mëdha në pamundsi të ujitet toka nuk jep rendimente.

Ali Blakaj, përfaqësues i ndermarrjes Drini i Bardhë" - Profesori ka të drejt, ka pas ujë të mjaftueshëm për ujitje, por tani është problemi se lejet për hurdhja të peshqive i jep Ministria dhe në drejtim të këtij kanali tani i kemi kater hurdhja të peshqve e qe neva na është veshtirsuar puna në marrjen e masave.

Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqiptar- kto hurdhja të peshqve e kanë obligim që me pompa sidomos gjatë sezonit të ujitjes ta kthejnë ujin në kanal, së paku kështu flitet në opinjon, pyetja është a është e vërrtet kjo dhe kush duhet ta menaxhoj këtë proces.

Ali Blakaj, perfaqesues i ndermarrjes Drini i Bardhe - Ka diçka në këtë drejtim por pompat nuk ka mundësi ta rikthejn gjithë sasin e ujit të shfrytëzuar në kanal.

Astrit Hajrizaj, Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi, pylltari- Po, z. Zenun ka plotsisht të drejt, ligjerisht janë të obliguar ta riciklojn apo filtrojn dhe ta kthejn në kanal. Ka hurdha që i shfrytëzojn dy kanale andaj mendoj që Drejtorati i Inspektoratit duhet ta kontrollojn dhe vlersojn që ujin e shfrytëzuar a e kthejn në kanal apo jo dhe të ndermarrin masa që ky rregull të zbztohet. Janë disa hurdha që e shfrytëzojn ujin nga dy kanalet por që e kanë të percaktuar në cilin kanal duhet kthyer. Pra duhet bër vlersimi i gjendjes faktike dhe të ndermirrën masa.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Shqetsimin të cilin e ngriti z. Zenun është mirë me që prezent e kemi edhe përfaqesuesin e " Drinit të Bardhe" që së bashku me Ministrin e linjes të gjindet zgjidhja e duhur. Me sa kamë unë informacione këto pompa janë të kushtueshme, andaj duhet gjetë zgjidhjen me Ministrin e linjës, sepse kerkesat e fermerve të asaj ane janë të shumta për gjetjen e zgjidhjes. Nese nuk ka më pyetje kalojm në pikën e radhes të rëndit të ditës.

8. Të ndryshme

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave- Do të doja që së bashku me antarët e KKSB-së e në veçanti me Policin e Kosovës ta bëjm një vlersim dhe nxirrje të konkluzioneve lidhur me temat që i debatojm. Shqetsimi i ka hershëm që e debatojm lidhur me sigurin në komunikacion e në veçanti në afersi të shkollave ku kemi pas edhe lendime me fatalitet më ka shtyr të bëj një analiz për mundësit e gjetjes së zgjidhjes.

Një form që po praktikohet me pengesat horizontale në rrugë si duket ka filluar tna bëhet praktik pa analizuar edhe anët negative. Në hyrje të Pejës nga Shkolla Ekonomike gjer në Qender janë vëndos kater pengesa të tilla, perpos automjeteve të rendomta që duhet pothuajse gati të ndalen paramendojini autoambulancat me të sëmur ku jeta e tyre mund të ndryshoj nga sekondat apo minutat dhe autoambulanca humb disa minuta në këto kater pengesa dhe së fundmi në pergjegjësi vetanake qytetart po qesin vend e pa vend këso lloje të pengesave qoft edhe të modifikuara.

Në perendim në shumë vende perdoren blic kamerat që obligojn vozitësit të kufizojn shpejtësin perndryshe nga fotot e bëra paguhen gjoba për tejkalim shpejtsije. Nisur nga ky fakt se pos që do të ndikoj në zvoglimin e shpejtësis do të jet edhe profitabil dhe do të krijoj të hyra për mirmbajtje dhe zgjerim nxënsit do të njehen të sigurt në komunikacion.

Unë kam kontaktu bashkëatdhetar tonë, asambleist në qytetin e Minhenit për ndihm në këtë drejtim. Këto paisje janë bukurr të kushtueshme, por një inicijativ të till nisur nga Komuna e Istogut e perkrahur në asociacionin e Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Policin e Kosovës ku do të nxirren shkollat në afersi të rrugve kryesore dhe do evidentohen rastet me fatalitet do të jetë mundsësi e mirë për

kërkim donacionesh nga Bashkimi evropian.

Kërkesa ime është që komandanti i Policisë të ngris këtë çështje në regjionin e Pejes me kërkes që të procesohet tutje në nivel Kosovës dhe të grumbullohen rastet e aksidenteve me fatalitet dhe lëndime trupore të nxënësve dhe të ipet një përgjigje a ka mundësi Policia në vazhdim ti menaxhoj, ndersa Kryetari i komunës të inicoj në asociacionin e komunave të Kosovës. Nëse gjen mbështetje atëher duhet ti qasemi këtij problemi për të hartuar si projekt për donacion nga Bashkimi European.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Pasi që nuk ka të lajmruar për fjalë, konstatoj se mbledhja e datës 11.10.2022 me kaq perfundon dhe kërktoj nga gjithë antarët e KKSb-së që për takimet e radhës të jeni të gjithë të përgatitur nga fusha dhe komuniteti që mbuloni. Të japim vlersime dhe propozime konkrete të cilat do ti nxhjerim si konkluzione dhe në takimet e radhës ti analizojm a janë plotsuar apo ka ngecje dhe arsyet e ngecjeve. Ju faleminderit për pjesmarrje dhe për angazhimin tuaj dhe shihemi në takimin e radhës.

Mbledhja perfundoj:

17.20